



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2025

Shtojca 13

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT**

Data 11.02.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik “BAMI HOLDING” SHPK, me numër NIPTI J94416206R,
Adresa: Durres Fushe Kruje FUSHE KRUJE Rruga Kamas.

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-26049-10-23-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Asfaltim i rruges në Zheje (varrezat), Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: 10,219,096 (dhjetë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit:
31.01.2025.

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Nr.6, datë 03.02.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “RSM COMPANY” SHPK, me numër NIPTI 810802422.

Vlera e ofertuar: 7,149,050 (shtatë milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëdhjetë) lekë **pa TVSH.**

2. Operatori ekonomik **“2 N” SHPK**, me numër NIPTI **L31615017L.**

Vlera e ofertuar: 8,229,182 (tetë milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë **pa TVSH.**

3. Operatori ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me numër NIPTI **J94416206R.**

Vlera e ofertuar: 8,257,200 (tetë milion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë **pa TVSH.**

4. Operatori ekonomik **“Caushi M” SHPK**, me numër NIPTI **L88419801O.**

Vlera e ofertuar: 8,289,200 (tetë milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë **pa TVSH.**

5. Operatori ekonomik **“ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **K82230002K.**

Vlera e ofertuar: 9,780,150 (nëntë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë **pa TVSH.**

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“RSM COMPANY” SHPK**, me numër NIPTI **810802422.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. **OE nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST, (për punë të ngjashme) për sa më poshtë vijon:**

Së pari: Operatori ekonomik **“RSM COMPANY” SHPK**, nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në DST, pasi nuk ka paraqitur për punë të ngjashme dokumentacionin si më poshtë:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9.
- Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;

Autoriteti Kontraktor, këto kërkesa i ka përcaktuar në pikën 2.3.1 në DST dhe operatori ekonomik ofertues, është i detyruar që ofertën ta plotësojë sipas kërkesave të AK. Ligji dhe VKM për prokurimin publik si dhe KPP në vendimet e saj thekson se operatori ekonomik pjesmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojë vetëm kërkesat e vendosura nga AK në dokumentat e tenderit, e rrjedhimisht vlerësimi e kualifikimi i tyre bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nëse OE do të kishte pretendime në lidhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga AK në DST, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës ose të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë AK, lidhur me kërkesat e përcaktuara nga AK në DST. KPP si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, në vendimet e saj thekson se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Së dyti: Gjithashtu sqarojmë se puna e ngjashme që OE ka paraqitur nuk është bindëse, pasi referuar dokumentacionit që ky OE ka ngarkuar në SPE (References leshuar nga Ministria e Infrastrukturës si dhe Kontratës datë 28.09.2016) rezulton se:

- Në kontratën datë 28.09.2016, afati i punimeve është 113 ditë.
- Punimet kanë filluar me datë 2.11.2016 dhe kanë përfunduar me datë 3.06.2020 (që i bie që kanë zgjatur rreth 4 vite).

Po ashtu Komisioni i ngritur nga Ministria e Infrastrukturës për pranimin teknik të punës, në procesverbalin e mbajtur në pikën 4.1 të tij ndër të tjera shprehet:**duhet theksuar se gjatë realizimit të punimeve ka pas ndërprerje të shpeshta të punimeve shkaku i mos seriozitetit të kompanisë punëkryese.....**Në bazë të verifikimit të Ditarit Ndërtimor del se janë (350) ditë pune, **çka do të thotë se operatori ekonomik ka tejkaluar dinamikën e paraparë në kontratë (sipas planit dinamik 113 ditë).**

Sa më sipër puna e ngjashme e paraqitur nga OE, edhe pse nuk ka dokumentacioni sipas kërkesave të përcaktuara nga AK në DST, gjithashtu nuk është bindëse dhe nuk garanton Autoritetin Kontraktor se ky OE e kryen punën brenda afateve dhe me cilësi.

2. Operatori ekonomik “2 N” SHPK, me numër NIPTI L31615017L.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “2 N” SHPK, dokumentacion i cili u protokollua në Bashkinë Kurbin me Nr.4955/1 Prot, datë 27.12.2024, konstatoi se operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, si më poshtë:

Së pari: Operatori ekonomik “2 N” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.3.a të DST (konkretisht për Inxhinier Ndërtimi 1).

Autriteti Kontraktor në DST ka përcaktuar pikën 2.3.3 duke kërkuar se:

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)

b. Inxhinier Gjeodet/topograf/makshajder 1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për sejcilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqese, Kontratë pune e vlefshme, diplomë , dhe CV, si dhe **duhet të jetë në Listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën muajn e fundit të deklaruar.**

Sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar Inxhinier Ndërtimi Z. Enkelejd Shaqiri.

Por KVO, pasi verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur (sqarojmë se OE ka paraqitur listëpagesën e muajt tetor 2024), konstatoi se Inxhinieri i Ndërtimit Z. Enkelejd Shaqiri, nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë në muajn tetor 2024.

Së dyti: Operatori ekonomik “2 N” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.7 të DST (konkretisht për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt).

Autriteti Kontraktor në DST ka përcaktuar pikën 2.3.7 duke kërkuar se:

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktoje **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt.** Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; Kontrata e punës e vlefshme, Diploma si dhe **të figuroje ne listëpagesa per te paktën muajn e fundit te deklaruar.**

Sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar Drejtues Teknik Ing.Enkelejd Shaqiri.

Por KVO, pasi verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur (sqarojmë se OE ka paraqitur listëpagesën e muajt tetor 2024), konstatoi se Ing.Enkelejd Shaqiri, nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë në muajn tetor 2024.

Së treti: Operatori ekonomik “2 N” SHPK, nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST (për taksat vendore).

Autriteti Kontraktor në DST ka përcaktuar pikën 2.2.2 duke kërkuar se:

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2024 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Duke qënë para faktit se OE “2 N”, ka kontratë të lidhur me Bashkinë Kurbin në vitin 2024 (për punime ndërtimi), KVO me shkresën Nr.6480 Prot, datë 31.12.2024, ju drejtua Drejtorisë së Planifikimit të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin, duke i kërkuar informacion, nëse subjekti “2 N”, ka likujduar apo jo taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Kurbin.

Me shkresën Nr.6480/1 Prot, datë 06.01.2024, Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore e Bashkisë Kurbin, na informoi se subjekti “2N” SHPK, me numër NIPTI L31615017L, është debitor në vlerën 20,375 ndaj Bashkisë Kurbin.

Për sa më sipër, KVO nuk mund të kualifikojë një operator ekonomik, i cili nuk plotëson/paraqet dokumentacionin sipas kërkesave që Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “2 N” SHPK, S’Kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me adresë: Durrës Fushe Kruje FUSHE KRUJE Rruga Kameras, se oferta e paraqitur me vlerë të përgjithshme prej: **8,257,200** (tetë milion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe do të veprohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit:

JO (Nuk ka patur)

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Majlinda CARA